

## **Adresimi proporcional i SNA-ve te qartesuara ne auditimin e pasqyrave financiare sipas SKK te permiresuara**

***Prof.Dr. Hysen CELA***

***Kryetar i Keshillit Drejtues***

***Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar te Shqiperise  
IEKA***

Te dashur kolege!

Te nderuar pjesemarres te ketij aktiviteti!

Ne radhe te pare deshiroj te falendoj KKK dhe kryetarin e tij z. Bollano, per sensibilizimit te vazhdueshem qe i ben ceshtjeve te raportimit financiar te bsueshem.

Te gjithë jemi te vetedijshem se zhvillimi ekonomik i qendrueshem nuk mund te arrihet pa angazhimin dhe perdorimin eficient te burimeve materiale, njerezore dhe financiare, te cilat duke u kombinuar midis tyre bejne te mundur transformimin ne produkte dhe te mira per te gjithë anetaret e shoqerine. Nje process i tille transformues behet i mundur permes veprimtarive te biznesit, te cilat prodhojne te ardhura si per individet pjesemarres ashtu edhe per qeverine, e cila i kthen keto te ardhura ne sherbime dhe te mira publike.

Burimet financiare per kompanite, vijne nga shume drejtime, ku mund te permenden investimet e ndermjetesuara nga bursat e tregjeve financiare, investimet direkte te kompanive dhe individeve, si edhe nga financimet e institucioneve financiare dhe te kreditimit. Sa me te garantuara të jene burimet financiare, aq me shume ka te ngjareqe veprimtarite e biznesit te kene jetegjatesi dhe te plotesojne rolin dhe misionin e tyre. Siguria e financimit ka ne themel vleresimin reciprok te interesave te paleve dhe ne kete aspekt, si fill lidhes eshte dhe mbetet besimi. Askush nuk mund te investoje para per te humbur.Por, qe te investohen burimet financiare, palet kane nevojë per njohje te veprimtarive te biznesit, atyre ju duhet nje informacion i besueshem, i cili per pjesen me te madhe te perdoruesve nuk mund te vije pervese nga raportet financiare dhe pasqyrat financiare qe paraqiten per qellime te perjithshme.

E bera kete hyrje, per te treguar se besimi ne informacionet financiare historike eshte motori levizes i biznesit eshte promotori i zhvillimit dhe garantuesi i stabilitetit dhe zhvillimit te qendrueshem. Tema qe une kam zgjedhur per ta trajtuar ne kete aktivitet synon te analizojene menyre modeste pikerisht marredhenien qe vendoset midis besimit dhe saktësisë apo drejtësisë se paraqitjes se informacioneve financiare vjetore te entiteteve te biznesit. Ne te vertete besimi, brenda kuadrit te organizimit dhe funksionimit te nje biznesi, sherben sinxites per nje kontribut te shtuar dhe te deshiruar te punonjesve dhe menaxherve, pasi e ben lidhjen

e tyre me entitetin me te forte dhe me te qendrushme. Nga ana tjetere, besimi tek te dhenat financiare garanton investoret per rikthimin efektiv te shumave te investuara dhe shton perkrahjen e publikut, i cili mbeshtet jo vetem produktet apo sherbimet qe ofrohen nga entiteti, por edhe kontributet e entitetit ne forma te ndryshme te pergjegjesise sociale. Pervec kesaj, besimi e siguron edhe qeverine se ajo do te mbledhe taksat dhe tatimet e duhura, si edhe bankat apo institucionet e kreditimit, qe ato te mund te huazojne per biznesin shuma parash, pa patur friken apo ne kushtet e nje niveli te ulet te rrezikut te humbjes se shumave te dhena hua.

Raportimi financiar i besueshem, i cili qendron ne themel te marredhenieve te biznesit me palet e interesuara, nuk mund te arrihet pa standarde teknike e profesionale cilesore dhe as pa individe te pergatitur, te cilet manifestojne sjellje etike, integritet, objektivitete dhe pavaresi.

Mendoj se hapat e ndermarra ne vendin tone per te reformuar raportimin financiar, te cilat kane nisur qe ne vitet e para te ketij shekulli, i kane sherbyer pikerisht ketij qellimi, rikonsiderimit dhe vleresimit te duhur te institucionit te besimit. Ne kete drejtim mund te permendim ndryshimin e ligjit per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare (2004), punen per hartimin e SKK -ve (2006), punen per permiresimin e SKK -ve (2014), plotesimin e SKK-ve me SKK 15, i cili eshte i orientuar teresisht ne pasqyrat financiare te mikronjesive, hartimin e nje standardi te vecante per OJF-te, etj. Gjate kesaj periudhe KKK ne rolin e hartuesit te standardeve, ka bere te mundur edhe hartimin e guidave udhezuese dhe sidomos, plotesimin e literatures profesionale duke perkthyer dhe publikuar SNRF-te por edhe SNRF per SME-te.

Pra, ne kontekstin institucional dhe sidomos te standardeve te raportimit, duhet thene se pergjithesisht ka nje baze te shendoshe per te garantuar nje raportim te besueshem. Megjithate, problem mendoj se mbetet zgjerimi me shume se sa duhet i disa kerkesave ne rastin e raportimit financiar vjetor te mikroentiteteve, por dhe te OJF-ve, te cilat per nga natyra jane te vogla ne madhesi dhe kane nje interes publik te kufizuar. Per rrjedhoje do te ishte mire qe kerkesat e raportimit per keto kategori entitetesh, kufijte e te cilave dukshem jane poshte kufijve qezbatohen ne BE, te thjeshtohen me tej dhe pasqyrat financiare vjetore te tyre te kufizohen vetem ne pasqyrene te ardhurave, te shoqeruar me informacione shtese per pozicionin financiar, ose vetem ne dy pasqyra duke perfshire, krahas pasqyres se te ardhurave edhe pasqyren e pozicionit financiar, si edhe te kene nje thjeshtim dhe nje standardizim me te madh ne shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare.

Megjithate, kuadri i raportimit, sado cilesor dhe sado ne koherence me kuadrin nderkometar te jete, nuk mund te coje ne drejtimeduhur pa punen e individeve, te cilet kane detyrimin te hartojne pasqyrat financiare, pergatitja e te cileve, me gjithë progresin e bere gjate ketyre dekadave te tranzicionit, le persersi per te deshruar. Gjate gjithë ketyre viteve vemendja e organizatave profesionale te kontabilitetit ka qene e fokusuar dhe perqendruar vetem ne pergatitjen e profesionistev qe i takojne niveleve te larta te ekspertizes, duke lene keshtu deri duku pas dore stadet apo nivelet e ndermjeteme te profesionit, sic jane tekniket kontabel apo llogaritaret. Jane pikerisht anetaret e kesaj kategorie te profesionit, te cilet ne te vertete kane nje rol shume te madh per te luajtur, vecanerisht ne regjistrimet kontabel dhe respektimin e

standardeve te kontabilitetit. Tendenca e ketyre viteve te fundit, per t'u fokusuar direkt ne nivelet me te larta profesionale, ka bere qe te adresohen pak aspekte profesionale praktike dhe trajnimet te vijojne te jene perseri nje vazhdim i trajtimit teorik te bere nga shkollat e larta, cka ka sjelle dublim ne trajtimet profesionale gjate trajnimeve dhe ineficence ne perpjekjet e bera.

Sidoqofte, une do te ndalem fillimisht tek SKK-te. Ne versionine ri, ate te permiresuar te tyre, ato duket se garantojne qe entitetet do te paraqesin drejt pozicionin dhe performancene tyre financiare, por problem mbetet kontrolli ketij raportimi, pra nese SKK-te jane zbatuar drejtose jo. Kjo gje behet me shume e pambuluar po te kemi parasysh qe per pjesen me te madhe te shpk-ve nuk do te kete auditim ligjor te detyruarduke filluar mga viti 2017, per shkak se ndryshimet e fundit ligjore ne ligjin per auditimin dhe profesionin i kane rivleresuar ne rritje treguesi qe duhet te permbushin entitetet per te qene te detyruar te auditojne pasqyrat financiare.

Rritja e kufijve te auditimit (te ardhurat dhe aktivet totale) me gati tre here, do te nxjerre ne pah nje renie te cilesise se raportimit financiar, pasi keto pasqyra per shkak se nuk do ti nenshtrohen auditimit te detyrueshem, do te mbeten edhe te parishikuara nga nje auditues i pavarur. Keshilli Kombetar i Kontabilitetit nuk e ka detyrim ligjor te kontrolloje cilesine e raportimit financiar. Por edhe po ta kishte kete te drejte, burimet per te bere nje gje te tille nuk ekzistojne.

Pervoja aktuale, por edhe e te gjithë periudhes, gjate se ciles ne Shqiperi eshte zbatuar ne praktike auditimi i pavarur i pasqyrave financiare te entiteteve te biznesit, tregon se audituesit kane kontribuar dukshem ne permiresimin e cilesise se pasqyrave, ndonese shume nga kjo pune mund te mos kete gjetur dokumentimin e duhur ne dosjet perkatese te audituesve. Heqja e ketij detyrimi, ndonese eshte pare si reduktim i koston per biznesin, kurrsesi nuk mund te justifikojë renien e cilesise se raporteve financiare, pasi keto entitete do te vijojne te paraqesin interes publik, vecanerisht ne ato raste kur detyrohen te paguajne taksat dhe tatimet, kerkojne te marrin kredi nga bankat dhe institucionet financiare apo kur kerkojne te marrin pjese ne tenderat per punet publike. IEKA mbetet e opinionit se auditimi i te gjithë shpk-ve, po te shikohet ne raportin kosto perfitim anon pikerisht nga perfitimi, pasi nje informacion cilesor financiar i tyre i hap rrugen e rritjes permes zgjerimit te aktivitetit, pjesemarrjes ne punet publike, zhivillimit te nishativave te reja inovative permes financimeve nga bankat, etj. Per me teper, nje pervoje e tille ka qene e pranishme per disa dekada ne vendet nordike (Suedi, Danimarkë, Norvegji, Estoni, te clat kane shkuar me tej duke hartuar kohet e fundit edhe nje standard auditimi specifik qe mund te perdoret nga SMP-te per auditimin e SME-ve), vazhon te jete ende ne Qipro, Malte, Izrael, etj., dhe ka dhene rezultate te kenaqshme.

Ne kushte kur ndryshimi ligjor ka ndodhur, ne si organizem professional na del per detyre te reagojme ne menyren e duhur, duke u nisur nga pritshmëritë e biznesit. Ne si IEKA jemi te ndergjigjshem, se me gjithë rritjen e niveleve, perseri entitetet e biznesit do ta paraqesin si nevoje te tyre te brendshme rishikimin e informacioneve financiare historike, keshtu qe po i orientojme anetaret tane t'ju pergjigjen mese miri kerkesave te biznesit, duke strukturuar me

mire organizimine tyre, por edhe duke zhvilluar te gjitha zotesite e nevojshme per kete qellim. IEKA aktualisht po punon per te ndertuar nje pakete te plote te auditimit te SME-ve, pra edhe te shpk-ve qe nuk i nenshtrohen auditimit ligjor, duke nisur nga procedurat dhe udhezimet e shkruara per te vijuar me tej me programet respektive aplikative qe do te ndihmojne perzgjedhjen dhe zbatimine procedurave te punes por edhe vleresimin e rezikut, konkluzionet dhe dokumentimin e tyre. Kerkesat vullnetare per auditimin mendojme se do te stimulohen nga shume faktore, sic janefinancimi, pjesmarrja ne punet publike, ratingu ne rastet e berjeve apo bashkimeve, etj.

Per te harmonizuar dhe plotesuar me te mire kerkesat per auditimin ligjor, auditimin vullnetar dhe rishikimin vullnetar te informacioneve, eshte nevojshme qe SNA-te te perdoren ne menyre proporcionale ose te shkallezuar (scalable).SNA-te e qartesuara te IFAC-ut, kane krijuar mundesine qe te perdoren ne varesi te madhesis se biznesit, cka nenkupton se procedurat duhet te zgjidhen ne varesi te madhesis dhe po keshtu, te zbatohen edhe SNA-te. Ne kete drejtim IFAC ka publikuar ne dy volume edhe nje Guide per auditimin e SME-ve bazuar ne perdorimin proporcional te SNA-ve. IEKA ka shkuar me tej duke hartuar nje manual procedural me te permbledhur ne kete drejtim, i cili synon te orientoje ne menyre eficente punen audituese ne rastet e SME-ve. Hedhja e hapave te metejshme kerkon padyshim nje harmonizim te zbatimit te SNA-ve te qartesuara me SKK-te e permiresuara. Kjo mendoj se kerkon te ndertohen instrumente ndihmese per hartuesit e pasqyrave financiare. Propozimi yne eshte qe KKK ne bashkepunim me organizmat profesionale, por edhe me konsulnete te pavarur sic mund te jene konsulentet e projektit te Bankes Boterore, pervec manualit te zbatimit te SKK-ve, te hartojne nje dokument me te permbledhur ne formen e nje checkliste per zbatimine SKK-ve te permiresuara, me anen e te cilit te referohet per cdo ze ne pasqyrat financiare, numri i standardit dhe paragrafi qe zbatohet. Kjo pune do te ndihmoje jo vetem per aspektet e njohjes, matjes dhe paraqitjes, por edhe per te bere nje vleresim te pergjithshem te paraqitjes se pasqyrave financiare per qellime te pergjithshme. Kydokument, mund te perdoret gjithashtu edhe nga audituesit, por edhe nga profesionistet e teknologjise seinformacionit qe do te pershtatin programet qe IEKA ka perzgjedhur per qellime te vleresimit dhe auditimit te pasqyrave financiare sipas SKK-ve.

Pra, si perfundim, ne mendojme se nje bashkepunim efektiv me te gjitha aktoret do te garantoje besimin tek pasyrat financiare.Kjo kerkon sic e thashe edhe ne krye te ketij punimi, standarde te qarta, guida te zbatueshme, cheklista referuese, profesioniste te pergatitur dhe natyrisht nje mbikeqyrje efektive dhe te pavarur qe te mund te adresohet ne menyren e duhur asimetria e informacioneve midis dhenesve dhe marresve te sherbimit. Ne kete menyre, ne do te lidhim ne zbatimin e standardeve te kontabilitetit me perdorimin e standardeve dhe procedurave te auditimit.

**Ju faleminderit per vemendjen**